

PP 1A



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

UDHËZIM

NR. 04, DATË 20.11.2012

**“PËR
MËNYRËN E VLERËSIMIT TË REZULTATEVE INDIVIDUALE NË
PUNË TË OFICERËVE TË SEKSIONEVE TË POLICISË GJYQËSORE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “gj” i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar) dhe nenit 12/c pika 6 i ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, (të ndryshuar):

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i vlerësimit

1. Vlerësimi i rezultateve individuale në punë të oficerëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore synon:
 - a) rritjen e përgjegjësisë së oficerëve të Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre;
 - b) promovimin e qëndrueshmërisë në detyrë të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe marrjen e masave disiplinore ndaj atyre që vlerësohen të paaftë;
 - c) identifikimin e mangësive profesionale dhe nevojat për trajnimin e tyre.

Neni 2

Koha, mënyra dhe forma e vlerësimit

1. Brenda muajit Janar të çdo viti, drejtuesi i prokurorisë së rrethit i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm për miratim, vlerësimin e rezultateve të punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore.
2. Vlerësimi i rezultateve individuale në punë të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe rivlerësimi sipas pikës 3 të këtij neni, bëhet sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Vlerësimi

2. Vlerësimi i rezultateve individuale në punë të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe rivlerësimi sipas pikës 3 të këtij neni, bëhet sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Vlerësimi shoqërohet me treguesit e volumit, cilësisë dhe shpejtësisë, aneksi nr.2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili është pjesë përbërëse e aktit të vlerësimit.
3. Prokurori pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, që shqyrton vlerësimin, sipas rastit, kryesisht ose në bazë të ankimit të oficerit të policisë gjyqësore sipas nenit 9 të këtij udhëzimi, kur çmon se vlerësimi i bërë nga drejtuesi i prokurorisë është i padrejtë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e këtij udhëzimi, bën rivlerësimin e rezultateve të punës të oficerit të Policisë Gjyqësore, dhe ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm për miratim. Në çdo rast, rivlerësimi bëhet përpara miratimit të vlerësimit nga Prokurori i Përgjithshëm.
4. Akti i vlerësimit bëhet pjesë e dosjes personale të oficerit të Policisë Gjyqësore.

KREU II

KRITERET E VLERËSIMIT

Neni 3

Kriteret e vlerësimit

1. Vlerësimit i rezultateve individuale në punë të oficerëve të Policisë Gjyqësore bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:
 - a) Aftësitë profesionale juridiko-teknike;
 - b) Aftësitë e përgjithshme profesionale;
 - c) Aftësitë për zgjidhje;
 - ç) Aftësitë organizative;
 - d) Elementë të tjerë vlerësimi dhe informues.

Neni 4

Aftësitë profesionale juridiko-teknike

1. Aftësitë profesionale juridiko-teknike vlerësohen nga treguesit e mëposhtëm:
 - a) Vlerësimi i volumit, cilësisë dhe shpejtësisë, i cili bëhet sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - b) Raporti i përqindjes ndërmjet kallzimeve të marra dhe gjetjes së autorëve të krimit. Ky raport tregon forcën zbuluese të oficerit të policisë gjyqësore;
 - c) Raporti i përqindjes ndërmjet veprimeve të ndryshme hetimore si eksperiment, paraqitje për njohje etj dhe deklarimit të pavlefshëm të këtyre veprimeve nga prokurori. Ky raport tregon zbatimin e metodikave të hetimit dhe normave procedurale;
 - ç) Raporti i përqindjes së veprimeve simuluese për sigurimin e provës dhe deklarimin e tyre të papërdorshme nga prokurori. Ky raport tregon cilësinë e zbatimit të ligjit procedural penal;
 - d) Raporti i dosjeve të hetuara dhe veprimeve hetimore të deklaruara të pavlefshme nga prokurori. Ky raport tregon cilësinë e zbatimit të ligjit procedural penal;
 - dh) Raporti ndërmjet dosjeve të dërguara në gjyq me ato të pushuara dhe pezulluara. Ky raport tregon forcën zbuluese të oficerit të policisë gjyqësore;

Neni 5

Aftësitë e përgjithshme profesionale

1. Në aftësitë e përgjithshme profesionale, përfshihen elementët përbërës, si më poshtë:
 - a) Aftësia për të vepruar dhe për të përvetësuar, që është aftësia për të analizuar punët si dhe për t'u përditësuar dhe përmirësuar profesionalisht;
 - b) Aftësia për analizë dhe sintezë, që është aftësia për të mbledhur, arsyetuar dhe përdorur informacionin në mënyrën e duhur;
 - c) Aftësia për iniciativë dhe për propozim, që është aftësia për të propozuar zgjidhje dhe për të marrë vendime të shpejta dhe me vetë-përgjegjësi.
 - ç) Aftësia e shfaqur në kryerjen e funksioneve në përputhje me vështirësinë e tyre, që është aftësia për të kryer detyrat e dhëna në përputhje me vështirësinë, kompleksitetin apo lehtësinë që shfaqin në raste të veçanta;
 - d) Vazhdimësia dhe disponibiliteti, që nënkupton shkallën e vazhdimësisë dhe interesit me të cilin kryhet detyra duke qenë në uniformitet me kërkesat dhe brenda afateve të shërbimit.

Neni 6

Aftësitë për zgjidhje

1. Në aftësitë për zgjidhje përfshihen:
 - a) Aftësia për të vlerësuar problemet, e cila është aftësia për të analizuar dhe balancuar problematikat të cilat hasen gjatë ushtrimit të funksioneve;
 - b) Aftësia për të individualizuar zgjedhjet në kohë dhe në mënyrë efektive, e cila është aftësia për të gjetur sa më shumë zgjidhje të mundshme dhe për të individualizuar atë të duhurën;
 - c) Aftësi në zbatimin e urdhrave dhe qartësi në dhënien e tyre, e cila nënkupton aftësinë për të kryer në mënyrë efektive çdo veprim hetimor që është urdhëruar ose deleguar nga prokurori, dhe dhënien në mënyrë të efektshme, të qartë dhe direkte të urdhrave personelit në varësi të tij;
 - ç) Aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi, e cila është aftësia për të ndërmarë në mënyrë të përgjegjshme iniciativa dhe vendime në mënyrë diskrete dhe në ushtrim të funksioneve ligjore.

Neni 7

Aftësitë organizative

1. Aftësitë organizative maten nga faktorët e mëposhtëm:
 - a) Aftësia për raporte ndërpersonale në administratë, që nënkupton krijimin e raporteve pozitive me të gjithë subjektet e procedimit penal dhe në veçanti prokurorin, kolegët dhe personelin administrativë;
 - b) Aftësia për raporte ndërpersonale jashtë administratës, që nënkupton aftësinë për të vendosur raporte të ekuilibruara dhe korrekte gjatë kryerjes së funksioneve, me institucione të tjera dhe me qytetarët;
 - c) Aftësia për të motivuar dhe përfshirë bashkëpunëtorët, që është aftësia për të nxitur kolegët të kontribuojnë në maksimum me të dhënat individuale në funksionimin e aktivitetit të përditshëm;

- ç) Aftësia për të drejtuar një grup pune, për të bashkërenduar veprimtaritë e vartësve, për të deleguar dhe monitoruar veprimtaritë e vartësve, dhe aftësia për të përfituar rezultate maksimale nga stafi.

Neni 8

Elementë të tjerë vlerësimi dhe informues

1. Elementët e tjerë të vlerësimit përfshijnë:
 - a) Aftësitë e të shprehurit dhe ato të komunikimit;
 - b) Cilësitë morale dhe të karakterit;
 - c) Kujdesi për paraqitjen;
 - ç) Përkushtimi për detyrën;
 - d) Ruajtja e sekretit dhe korrektësia në punë;
 - dh) Aftësi të spikatura për të kryer funksione të veçanta (juridike, administrative, tekniko-specialiste, etj).

KREU III

ANKIMI

Neni 9

E drejta e ankimit

1. Akti i vlerësimit dhe rivlerësimit sipas pikës 3 të nenit 2 të këtij udhëzimi, i bëhet i njohur menjëherë oficerit të Policisë Gjyqësore të vlerësuar, i cili ka të drejtë të paraqesë ankim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni, pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Ankimi shqyrtohet nga një Komision i përbërë nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe dy prokurorë të caktuar *ad hoc* nga Prokurori i Përgjithshëm. Komisioni pasi shqyrton dosjen e vlerësimit të oficerit të Policisë Gjyqësore dhe dëgjon oficerin e Policisë Gjyqësore, vendos pranimin ose mospranimin e ankimit. Në rast se ankimi pranohet, komisioni bën rivlerësimin e punës së oficerit të Policisë Gjyqësore dhe ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm për miratim.

Neni 10

Vlerësimi “I paaftë”

1. Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës disiplinore për shkarkimin nga detyra të oficerit të Policisë Gjyqësore.

Neni 11
Marrëdhëniet me tjerë

1. Drejtuesi i Prokurorisë ka të drejtë t'i drejtojë në çdo kohë titullarit nga i cili varet shërbimi përkatës i policisë gjyqësore, opinione të arsyetuara për agjentët apo oficerët e këtij shërbimi, në raste të gabimeve të rënda profesionale apo meritave të tyre.


Neni 12
Dispozita zbatuese

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 14
Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORILLPËRGJITHSHËM


INA RAMA

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

AKTI I VLERËSIMIT TË REZULTATEVE INDIVIDUALE NË PUNË TË OFICERËVE
TË SEKSIONEVE TË POLICISË GJYQËSORE

Viti referues _____

Vlerësimi	I paaftë	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyer
Pikët	1	2	3	4	5

1. ELEMENTE INFORMUES¹

Të dhëna personale

Emër Mbiemër _____
Datëlindja _____
Statusi Civil _____
Vendbanimi _____
Diplomuar (dega/viti) _____
Tituj profesional _____
Titujt dhe gradat _____
Pozicioni : _____
Spektori _____
Prokuroria _____

¹ Pika 1 e formularit "ELEMENTE INFORMUES" plotësohet nga oficeri i policisë gjyqësore që do të vlerësohet.

Të dhëna dytësore

Gjuhët e huaja_____
Njohuri në kompjuter_____
Njohje të tjera_____
Vlerësimi për pozicionin aktual_____
Synimet për pozicionin e punës_____
Situata personale të veçanta_____
Situata familjare të veçanta_____
Të ndryshme_____

2. ELEMENTËT E VLERËSIMIT

A. Aftësitë profesionale juridiko-teknike	Vlerësimi në pikë dhe komente
Vlerësimi i volumit, cilësisë dhe shpejtësisë	<input data-bbox="867 478 959 557" type="checkbox"/>
Raporti i përqindjes ndërmjet kallzimeve të marra dhe gjetjes së autorëve të krimit.	<input data-bbox="867 666 959 746" type="checkbox"/>
Raporti i përqindjes ndërmjet veprimeve të ndryshme hetimore si eksperiment, paraqitje për njohje etj dhe deklarimit të pavlefshëm të këtyre veprimeve nga prokurori.	<input data-bbox="867 852 959 932" type="checkbox"/>
Raporti i përqindjes së veprimeve simuluese për sigurimin e provës dhe deklarimin e tyre të papërdorshme nga prokurori.	<input data-bbox="867 1034 959 1113" type="checkbox"/>
Raporti i dosjeve të hetuara dhe veprimeve hetimore të deklaruar të pavlefshme nga prokurori	<input data-bbox="867 1192 959 1272" type="checkbox"/>
Raporti ndërmjet dosjeve të dërguara në gjyq me ato të pushuara dhe pezulluara	<input data-bbox="867 1374 959 1453" type="checkbox"/>

VLERËSIMI PËR KËTË KRITER

B. Aftësitë e përgjithshme profesionale

Aftësia për të vepruar	<input type="checkbox"/>
Aftësia për analizë dhe sintezë	<input type="checkbox"/>
Aftësia për iniciativë dhe propozime	<input type="checkbox"/>
Aftësia në kryerjen e funksioneve në bazë të vështirësive të këtyre funksioneve	<input type="checkbox"/>
Disponibiliteti në kryerjen e detyrës	<input type="checkbox"/>

VLERËSIMI PËR KËTË KRITER**C. Aftësitë për zgjidhje****Vlerësimi në pikë dhe komente**

Aftësia për të vlerësuar problemet	<input type="checkbox"/>
------------------------------------	--------------------------

Aftësia për të evidentuar në kohë dhe në mënyrë efikase	<input type="checkbox"/>
Aftësia në zbatimin e urdhrave dhe qartësia në dhënien e tyre	<input type="checkbox"/>
Aftësia për të mbajtur përgjegjësi	<input type="checkbox"/>

VLERËSIMI PËR KËTË KRITER

Ç. Aftësitë organizative

Vlerësimi në pikë dhe komente

Aftësia për raporte ndërpersonale në administratë	<input type="checkbox"/>
Aftësia për raporte ndërpersonale jashtë administratës	<input type="checkbox"/>
Aftësia për të motivuar dhe përfshirë bashkëpunëtorët	<input type="checkbox"/>

Aftësia për të drejtuar një grup pune dhe për të bashkërenduar punën	<input type="checkbox"/>
--	--------------------------

VLERËSIMI PËR KËTË KRITER <input type="checkbox"/>
--

D. Elementë të tjerë vlerësimi dhe informues

Vlerësimi në pikë dhe komente

Aftësitë e të shprehurit dhe ato të komunikimit	<input type="checkbox"/>
Cilësitë morale dhe të karakterit	<input type="checkbox"/>
Kujdesi për paraqitjen	<input type="checkbox"/>
Përkushtimi për detyrën	<input type="checkbox"/>
Ruajtja e sekretit dhe korrektësia në punë	<input type="checkbox"/>
Aftësi të spikatura për të kryer funksione të veçanta (juridike, administrative, tekniko-specialiste, etj)	<input type="checkbox"/>

VLERËSIMI PËR KËTË KRITER



3. SHËNIME TË MËTEJSHME

Motivime për ndryshime të mundshme nga akt vlerësimi i mëparshëm dhe arsyet për dhënien maksimale të pikëve

Konsiderata dhe vëzhgime

4. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR²

Data e aktit të vlerësimit

____/____/____

Data e marrjes dijeni

____/____/____

DREJTUESI I PROKURORISË

.....
(nënshkrimi)

OFICERI I POLICISË GJYQËSORE

.....
(nënshkrimi)

²Vlerësimi përfundimtar shprehet në një nga vlerësimet: "I paafte", "Mjaftueshëm", "Mirë", "Shumë mirë" dhe "Shkëlqyer".

Aneksi Nr. 2

**TREGUESIT E VOLUMIT, CILËSISË DHE SHPEJTËSISË PËR OFICERËT E
POLICISË GJYQËSORE
PROKURORIA E RRETHIT**

		Treguesit		Periudha	
				201	
Ndjekja penale në hetimet paraprake	Veprimet hetimore, zgjidhjet e rekomanduara dhe përfundimi	Veprimet hetimore	Referime	Ngjarje	
				Kallzime	
				Arrestime në flagrancë	
				Ndalime	
			Hetuar	Procedime	
				Të pandehur	
		Të arrestuar			
		Zgja tje afati	Për procedimet në hetim		
			Per te paraburgosurit ne hetim		
		Rekomandime pushimi	Procedime	Gjithsej	
				Mungesë fakti	
				Mungesë provash	
				Shkaqe të tjera	
			Të pandehur	Gjithsej	
				Mungesë fakti	
				Mungesë provash	
				Shkaqe të tjera	
		Mospranuar/ndryshuar			
		Rekomandime pezullimi	Gjithsej		
			Autori nuk dihet		
			I pandehuri sëmure		
			Mospranuar/ndryshuar		
		Rekomandime gjyqit	Procedime		
			Të pandehur		
Të arrestuar					
Mospranuar/ndryshuar					
Cilësia	Të pandehur	Të arrestuar	Pushuar/ndryshuar akuza		
			Revokuar/ndryshuar masa sig.		
			Pafajësi e plotë		
	Të lirë	Të lirë	Pushuar/ndryshuar akuza		
			Pafajësi e plotë		
			Pafajësi e pjesshme		
Akte	Absolutisht të pavlefshme				
	Relativisht të pavlefshme				
	Urdhra/vendime për anulimin e tyre				
Urdhra ekzekutimi të zbatuara					

DREJTUESI I PROKURORISË

OFICERI I POLICISË GJYQËSORE

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)